



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
Nr.prot. 1655, datë 12/05/2026



BASHKIA KOLONJË

Nr.prot. 303, datë 12/05/2026



AGJENCIA EKONOMIKE MBËSHTETËSE
ECONOMIC SUPPORT AGENCY

AEM

Nr.prot. 54, datë 12/05/2026



AGREGATORI

Nr.prot. 3, datë 12/05/2026



Nr.prot. 20, datë 12/05/2026



HUBEX

Nr.prot. 911, datë 12/05/2026



Green Kolonja

Green Kolonja sh.a

Nr.prot. 17, datë 14/05/2026



Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor

“ARRKO”

AKTI I THEMELIMIT

Në Tiranë, sot më datë 12.05.2026, nismëtarët e mëposhtëm, personat juridikë:

1. **Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)**, person juridik shqiptar me zotësi të plotë juridike, me NIPT: J62325010W, dhe adresë Rr. "Sami Frashëri", nr. 10, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. **Dritan Agolli**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 14.09.1970, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti me nr. H00914093K;
2. **Bashkia Kolonjë**, një person juridik shqiptar me zotësi të plotë juridike, me NIPT: K48220001G dhe adresë sheshi "Rilindja", 7401, Ersekë, Shqipëri, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. **Erion Isai**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 01.11.1998, lindur në Kreshovë dhe banues në Kolonjë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti me nr. I81101097H;

3. **AGREGATORI-Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqeverisje**, organizatë jofitimprurëse, regjistruar me Vendimin nr. 1814, datë 14.04.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Rr. "Muhamet Gjollësja", Nd. 70/1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv zj. **Halissa Kastrati**, e datëlindjes 04.03.1998, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti me nr. J85304057J.

4. **Agjencia Ekonomike Mbështetëse (AEM)**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L81819025K, me seli në Njësinë Administrative nr. 7, në adresën: Rr. "Muhamet Gjollësja", ish-Instituti i Ndërtimit, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratorë z. **Alfred Dalipi**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 06.10.1970, lindur në Ersekë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti me nr. H01006022A; z. **Klodjan Bregu**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 30.03.1981, lindur në Leshnjë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti me nr. I10330074T, dhe z. **Gentian Picari**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 27.12.1990, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti me nr. J01227078M,

5. **Agjencia e Menaxhimit të Investimeve (AMI)**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS M22112037U, me seli në adresën: Rr. "Muhamet Gjollësja", Nd. 70/1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori z. **Shpati Braho**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20.03.1986, lindur në Potom dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti me nr. I60320003J,

6. **HUBEX-Qendra e Ekselencës për Inovacion dhe Dije**, organizatë jofitimprurëse, regjistruar me Vendimin nr. 1753 datë 15.09.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Rr. "Muhamet Gjollësja", Nd. 70/1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. **Amela Tushaj**, e datëlindjes 06.10.1998, Akt Themelimi "ARRKO"



lindur në Shkodër dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti me nr. J86006098C,

7. **Green Kolonja**, shoqëri aksionere, regjistruar në Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS M67801001A, me adresë: Sheshi “Rilindja”, Godina nr.2, Ersekë, Korçë, Shqipëri, përfaqësuar nga Administratori z. Ermal Zylfo, shtetas shqiptar, i datëlindjes 23.02.1986, lindur në Ersekë dhe banues në Ersekë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti me nr. I60223032L

I. Themelimi

- 1.1 Vendosin themelimin e Shoqërisë me emër “ARRKO” (këtu e në vijim “Shoqëria”), i cili paraprihet në mënyrë të pandashme nga fjalët “Shoqëria e bashkëpunimit bujqësor”, të cilat përfaqësojnë formën ligjore të saj.
- 1.2 Bazuar në ligjin nr. 38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, anëtarët themelues kanë vendosur të organizohen vullnetarisht me qëllim nxitjen e zhvillimit dhe prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të arrorëve, përpunimi i nënproduktit të tyre; Përpunimi i bimëve medicinale dhe nën produktet të tyre; Koordinim me anëtarët e shoqërisë për prodhimin e mjaltit elitare dhe nënproduktet e tij; Binjakëzim dhe bashkëveprim logjistik të unifikuar sipas rregullores të përbashkët, Shoqëria të bashkëpunojë me inputet në mënyrë që të kenë mundësi të përpunojë, të prodhojë dhe të fabrikojnë me çfarë do lloj procesi ushqimor sipas standardeve europiane.
- 1.3 Në të gjitha shkresat, publikimet dhe dokumentet e shoqërisë, emërtimi i saj paraprihet nga fjalët “Shoqëri e bashkëpunimit bujqësor”, pas të cilave shënohet emërtimi i shoqërisë dhe numri i regjistrimit të saj. Gjithashtu, në dokumentet, faturat, reklamimet dhe botimet e Shoqërisë, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, shënohen edhe: (i) adresa e regjistruar; si dhe (ii) pasqyrimi i faktit nëse shoqëria është në procedura likuidimi, në qoftë se ky rast paraqitet.
- 1.4 Në asnjë rast një shoqëri tjetër nuk mund të përdorë emërtimin e përcaktuar në nenin 1.1 të këtij Akt Themelimi.

II. Deklarata e anëtarësisë

- 2.1 Anëtarët themelues, me anë të nënshkrimit të aktit të themelimit, deklarojnë se përmbushin kriteret për të qenë anëtarë të shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor “ARRKO”, (këtu e në vijim “Anëtarët”).
- 2.2 7 (shtatë) anëtarët themelues pranojnë të zbatojnë aktin e themelimit, statutin dhe vendimet, politikat operacionale, marrëveshjet e shoqërisë, si dhe të zbatojnë standardet më të larta kombëtare dhe ndërkombëtare në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga anëtarësia në shoqëri.
- 2.3 Anëtarët, gjithashtu deklarojnë që në afërsinë e tyre nuk ekziston asnjë shkak që kufizon anëtarësinë e tyre në shoqëri.

Akt Themelimi “ARRKO”



- 2.4 Anëtarët janë përgjegjës për detyrimet e shoqërisë deri në vlerën e kontributeve të nënshkruara të kapitalit të shoqërisë të përfaqësuar në kuota (këtu e në vijim “Kuota”).

III. Selia

- 3.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. "Hyriet Novosela", ZK.1594, pranë rezervuarit, Ersekë, Kolonjë, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë.
- 3.3 Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

IV. Qëllimi

- 4.1 Shoqëria e bashkëpunimit bujqësor “ARRKO”, ka si qëllim ngritjen e një strukture të qëndrueshme bujqësore dhe bashkëpunuese duke synuar:
- a) Zhvillimin ekonomik të zonës së Kolonjës përmes promovimit të bujqësisë organike, përpunimit të produkteve vendore dhe nxitjes së bashkëpunimit midis fermerëve dhe operatorëve juridikë;
- b) Krijimin e një modeli eko-fermash ku prodhimi i arrorëve, bimëve medicinale dhe mjaltit ndërthuret me përpunimin dhe tregtimin e tyre dhe nënprodukteve të tyre sipas standardeve europiane;
- c) Garantimin e një menaxhimi të përbashkët, ndarje të drejtë të përfitimeve, mekanizim dhe automatizim të proceseve bujqësore dhe përdorim të energjive të rinovueshme, duke kontribuar në zhvillimin rural, rritjen e punësimit lokal dhe krijimin e një ekonomie të qëndrueshme e konkurruese të rajonit të Kolonjës nëpërmjet krijimit të Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB).

V. Objekti i veprimtarisë

- 5.1 Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me qëllimin e bashkëpunimit bujqësor dhe zhvillimit të qëndrueshëm rural, duke synuar përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale të anëtarëve, përmes organizimit dhe koordinimit të veprimtarive prodhuese, përpunuese, tregtare dhe shërbyese;
- 5.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është e orientuar në bashkëpunim të anëtarëve të saj në fushën e prodhimit bujqësor ose/dhe blegtoral, marketing dhe gjetjen e tregut duke prodhuar, përpunuar, ruajtur, klasifikuar, transportuar dhe shpërndarë produktet dhe nënproduktet e arrorëve, të tilla si arra ose lëmi, bimëve medicinale, mjaltit elitari, si dhe produkteve të tjera dhe nënprodukteve të tyre sipas dakordësisë së anëtarëve të Shoqërisë;
- 5.3 Shoqëria mund të kryejë veprimtari të punës bujqësore apo blegtorale për anëtarët ose të tretët, duke përfshirë dhe anëtarët punëtorë;

Akt Themelimi “ARRKO”



- 5.4 Shoqëria mund të kryejë veprimtari të furnizimit me mallra dhe shërbime të blera nga anëtarët, të tretët ose të prodhuara nga vetë Shoqëria, për përdorim dhe konsum të anëtarëve ose të tretëve;
- 5.5 Shoqëria mund të bashkëpunojë për inputet në mënyrë që të kenë mundësi të blejë apo përpunojë ushqime, plehra kimike, bimë, farëra, produkte fitosanitare, materiale, instrumente, makineri, impiante, produkte me prejardhje nga kafshët dhe çfarëdo lloj produktesh të tjera, të nevojshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e prodhimit, bujqësor dhe blegtoral;
- 5.6 Shoqëria mund të ofrojë shërbime të konsulencës, si dhe çdo shërbim tjetër të nevojshëm për anëtarët dhe jo vetëm, si dhe shërbime të sigurisë së objektit dhe informimit;
- 5.7 Binjakëzim dhe bashkëveprim logjistik të unifikuar sipas rregullores të përbashkët.

VI. Misioni i shoqërisë


Menaxhimi i objektit të veprimtarisë duke krijuar sinergjinë e nevojshme mes aktoreve për të realizuar objektin e veprimtarisë së shoqërisë me eficeincë dhe me standarte.

VII. FunkSIONET

Në zbatim të përbushjes së qëllimit të Shoqërisë, ajo ka funksionet e mëposhtme:

- d) Organizimi i prodhimit bujqësor dhe blegtoral, përmes përdorimit të përbashkët të tokës, makinerive, pajisjeve dhe infrastrukturës, si dhe koordinimit të proceseve të kultivimit, korryes, ruajtjes dhe transportit të produkteve.
- e) Furnizimi kolektiv me inpute bujqësore, duke blerë në mënyrë të përbashkët farëra, plehra, pesticide, karburante, makineri dhe materiale të tjera të nevojshme për anëtarët, me qëllim uljen e kostove dhe rritjen e eficiencës.
- f) Grumbullimi, standardizimi dhe tregtimi i përbashkët i produkteve, përfshirë klasifikimin, paketimin dhe shitjen kolektive të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale në tregjet vendase dhe të huaja.
- g) Përpunimi dhe marketingu i produkteve bujqësore, përmes krijimit të njësive të përbashkëta për përpunim, magazinim, etiketim dhe promovim të produkteve lokale, duke krijuar vlerë të shtuar për anëtarët.
- h) Ofrimi i shërbimeve të përbashkëta teknike dhe operacionale, përfshirë mekanizimin bujqësor, transportin, riparimin e pajisjeve, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe shërbimet e magazinimit.
- i) Hartimi dhe zbatimi i planeve të zhvillimit dhe projekteve investuese, përfshirë planin e biznesit shumëvjeçar, planin e marketingut, planin financiar dhe operacional, si dhe aplikimet për fonde zhvillimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
- j) Zhvillimi i kërkimit, trajnimit dhe inovacionit bujqësor, në bashkëpunim me institucione kërkimore, universitete, qendra inovacioni dhe partnerë të tjerë, për transferimin e dijes dhe teknologjive bashkëkohore në sektorin bujqësor.

Akt Themelimi "ARRKO"



- k) Mbështetja financiare dhe sigurimi bujqësor, përmes krijimit të fondeve të përbashkëta, garancive, instrumenteve financiare, sigurimeve bujqësore dhe mekanizmave të qasjes në kredi për anëtarët.
 - l) Mbrojtja e interesave ekonomike dhe mjedisore të anëtarëve, përmes promovimit të praktikave të qëndrueshme të prodhimit, menaxhimit të integruar të tokës dhe ruajtjes së biodiversitetit lokal.
 - m) Zhvillimi i veprimtarive plotësuese dhe ndihmëse, që lidhen me qëllimin e Shoqërisë, si turizmi rural, agroturizmi, promovimi i produkteve tradicionale, panairët dhe aktivitetet kulturore që mbështesin zhvillimin e territorit.
 - n) Krijimi dhe administrimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit institucional, me bashkitë, agjencitë publike, partnerët privatë dhe organizatat ndërkombëtare, për forcimin e zinxhirit të vlerës bujqësore dhe zhvillimin e qëndrueshëm territorial.
 - o) Përgatitja dhe miratimi i rregulloreve të brendshme, që përcaktojnë proceset, përgjegjësitë, strukturën organizative, sistemin e menaxhimit financiar dhe raportimin periodik për anëtarët.
 - p) Monitorimi dhe kontrolli i veprimtarive, përfshirë ndjekjen e zbatimit të projekteve, analizën e kostove, respektimin e standardeve teknike dhe cilësisë, si dhe certifikimin e punimeve e produkteve.
 - q) Zhvillimi i partneriteteve të reja strategjike, për të rritur aksesin në tregje, teknologji, fonde dhe ekspertizë ndërkombëtare.
- Kryerja e çdo veprimtarie tjetër të lejueshme me ligj, që lidhet me objektin e Shoqërisë dhe që i shërben përbushjes së qëllimit të saj.

VIII. Të drejtat e Shoqërisë

- 8.1 Shoqëria mund të realizojë çdo lloj aktiviteti, operacion financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi; financimin ose bashkëfinancimin e projekteve nëpërmjet instrumenteve ekonomike për realizimin e objektivave të përcaktuara në statut.
- 8.2 Shoqëria mund të hyjë në marrëveshje partneriteti për plotësimin e objektivave të saj, vetë apo në bashkëpunim me aktorë publikë dhe/ose privatë, vendas ose të huaj, duke realizuar çdo aktivitet të mundshëm brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni dhe statuti.
- 8.3 Kryen çdo veprim tjetër që favorizon dhe lehtëson përmirësimin ekonomik, teknik, të zonave rurale në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 8.4 Në përputhje me kuadrin ligjor të aplikueshëm, në mënyrë që të arrihet qëllimi i lartpërmendur, Shoqëria ka të drejtë:
 - a) të mundësojë trajnime profesionale për anëtarët e saj apo palët e treta;
 - b) të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar dhe industrial, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore, që mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë;
 - c) të kryejë çdo aktivitet në lidhje me publikimin, marketingun apo reklamimin;

Akt Themelimi "ARRKO"



- d) të zotërojë kuota/aksione apo çdo lloj interesi tjetër në shoqëri të tjera, pavarësisht fushës në të cilën kryejnë veprimtari këto shoqëri;
- e) të kryejë çdo veprim tjetër në përmbushje të interesave dhe nevojave të anëtarëve të saj sipas dispozitave të statutit dhe legjislacionit në fuqi;
- 8.5 Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e favorizon atë.
- 8.6 Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë ushtrimin e aktivitetit.
- 8.7 Shoqëria kryen veprimtari dhe shërbime në kuadër të objektit të përcaktuar më sipër, përveçse me anëtarët e saj edhe me persona fizikë ose juridikë, të tretë, jo anëtarë, deri në 40 (dyzet) për qind të totalit të të ardhurave nga veprimtari të saj, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 38/2012 “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”.

IX. Statuti

Anëtarët Themelues kanë rënë dakord për miratimin e Statutit të shoqërisë sipas tekstit bashkëlidhur këtij Akti Themelimi të nënshkruar rregullisht nga ortakët.

X. Kapitali i regjistruar

- 10.1 Vlera e Kapitalit të regjistruar të shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë.
- 10.2 Kapitali ndahet në 7 kuota, nga të cilat: 1 kuotë e zotëruar nga FSHZH me 30% të kapitalit me vlerë 30,000 (tridhjetë mijë) Lekë; 1 kuotë nga Bashkia Kolonjë me 30% të kapitalit me vlerë 30,000 (tridhjetë mijë) Lekë; 1 kuotë nga Agjencia Ekonomike Mbështetëse - AEM sh.p.k me 30% të kapitalit me vlerë 30,000 (tridhjetë mijë) Lekë dhe 4 kuota të tjera, me vlerë 2,500 (dy mijë e pesëqind) Lekë secila që zotërohen nga Operatorët e Zhvillimit Rajonal të krijuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe shoqëria e krijuar nga Bashkia Kolonjë “Green Kolonja” sh.a, të renditura nga numri 1 deri në numrin 7, të nënshkruara nga anëtarët themelues sipas tabelës në pikë 10.4 më poshtë.
- 10.3 Kontributet në natyrë duhet të shprehen në vlerë ekonomike në bazë të një raporti vlerësimi të bërë nga një ekspert. Raporti i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet qendrës kombëtare të biznesit së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.
- 10.4 Kapitali i regjistruar i shoqërisë zotërohet nga Anëtarët si më poshtë vijon:

Anëtari	Kuota	Numërtimi	Përqindja e zotëruar në kapital	Vlera nominale
Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH)	1	1	30%	30,000
Bashkia Kolonjë	1	2	30%	30,000
“Agjencia Ekonomike Mbështetëse” AEM sh.p.k.	1	3	30%	30,000
“Agjencia e Menaxhimit të Investimeve” AMI sh.p.k.	1	4	2.5%	2,500

Akti Themelimi “ARRKO”



“AGREGATORI-Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqeverisje”	1	5	2.5%	2,500
“HUBEX- Qendra e Ekselencës për Inovacion dhe Dije”	1	6	2.5%	2,500
“Green Kolonja” sh.a	1	7	2.5%	2,500

XI. Administratori

- 11.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator, të drejtat dhe detyrimet e të cilit janë të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, në Statutin e Shoqërisë si dhe në Aktin e Emërimit të tij.
- 11.2 Administrator i parë i Shoqërisë është: z. Shpati Braho, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20.03.1986, lindur në Potom dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nga dokumenti me nr. I60320003J,
- 11.3 Kohëzgjatja e funksionit të Administratorit është për një periudhë 3-vjeçare, duke filluar që nga data e themelimit, me të drejtë rizgjedhje.
- 11.4 Administratori vepron individualisht dhe si firmëtar i vetëm në lidhje me çdo çështje të Shoqërisë e cila i është caktuar shprehimisht ose në rast se nuk i është përcaktuar shprehimisht, çdo çështje që përfshihet në administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë.
- 11.5 Administratorit, të cilit i ka mbaruar mandati i plotë i emërimit, kryen vetëm ato detyra, të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e shoqërisë, deri në emërimin e administratorit të ri.

Më datë 12.05.2026, në Tiranë, u hartua dhe u nënshkrua, me vullnetin e lirë të anëtarëve themelues, ky Akt Themelimi i Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor “ARRKO”, në 9 (nëntë) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore

ANËTARËT THEMELUES

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
Përfaqësuar nga Drejtori/Ekzekutiv
Dritan Agolli

BASHKIA Kolonjë
Përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë
Erion Isai

AGREGATORI-Qendra për Zhvillim, Partneritet dhe Mirëqeverisje
Përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv/Partneritet dhe Mirëqeverisje
Halissa Kastrati

Akt Themelimi “ARRKO”

Agjencia Ekonomike Mbështetëse "AEM" sh.p.k.

Përfaqësuar nga Administratorët

Alfred Dalipi

Klodjan Bregu

Gentian Picari



Agjencia e Menaxhimit të Investimeve "AMI" sh.p.k.

Përfaqësuar nga Administratori

Shpati Braho



HUBEX-Qendra e Ekselencës për Inovacion dhe Dije

Përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv

Armela Tushaj

Green Kolonja sh.a

Përfaqësuar nga Administratori

Ermal Zylo

